

Thirrje për Konsulent/e

“Përtej barazisë numerike: Fuqizimi i Këshilltareve Komunale në Qeverisje Lokale”

Rreth Institutit Demokrasi për zhvillim

Instituti Demokrasi për zhvillim (D4D), është organizatë jo qeveritare e themeluar në prill të vitit 2010. Misioni i D4D-së është të ndikojë në proceset e zhvillimit të politikave publike në mënyrë që të përshpejtojë zhvillimin socio-ekonomik të vendit, përmirësimin e qeverisjes dhe për të përforcuar kulturën demokratike në Kosovë. Programet në të cilat Instituti D4D është i fokusuar janë: Analiza e Politikave dhe Hulumtimi; Qeverisja dhe Interesi Publik; Zgjedhjet dhe Partitë Politike; Dialogu dhe Bashkëpunimi Rajonal.

Përshkrim i shkurtë i projektit:

Instituti D4D është duke implementuar e projektin “Përtej barazisë numerike: Fuqizimi i Këshilltareve Komunale në Qeverisje Lokale”. Projekti ka për qëllim të forcojë avokimin dhe pjesëmarrjen aktive të grave në proceset politike, me fokus të veçantë të këshilltareve komunale në qeverisje lokale. Kjo synohet të arrihet kryesisht nëpërmjet programeve të zhvillimit të ngritjes së kapaciteteve dhe programeve të mentorimit. Fokus i këtij projekti janë gratë e reja që aspirojnë të angazhohen politikisht në partitë politike si dhe gratë që tashmë janë pjesë e Kuvendeve Komunale, duke vazhduar kështu ndërtimin e kapaciteteve të tyre si dhe duke u ofruar atyre njohuritë e nevojshme për të kuptuar më tej sistemin politik. Pilot komunat e përfshira në këtë projekt janë: Prishtina, Prizreni, Mitrovica, Kamenica dhe Istogu.

Instituti Demokrasi për zhvillim (D4D), në kuadër të këtij projekti hap thirrjen për Konsulent/e, për vlerësimin e nevojave bazë për politikëbërje nga ana e Këshilltareve Komunale.

Detyrat e Konsulentit/es:

Fushëveprimi i punës dhe detyrat e Konsulentit/es janë si më poshtë:

- (a) Të siguroj një listë me emra të akterëve të cilët do të intervistohen;
- (b) Të bëhet vlerësimi i nevojave bazë i Këshilltareve Komunale në komunat e targetuara; Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Kamenicë dhe Istog.
- (c) Të bëhet shkrimi i dokumentit i cili duhet të përfshijë elementet e listuara më poshtë (por, pa u kufizuar):
 - Analizë e thellë ndër vite (2000-2018), për pjesëmarrjen, përfshirjen, rolin dhe hapësirën e grave në qeverisjen lokale;



- Analizë dhe shqyrtim i sfidave të grave në politikë në qeverisje lokale në komunitatet e targetuara.

(d) Dërgimi i draftit të dokumentit për adresim të komenteve nga ana e D4D;

(e) Finalizimi i dokumentit pas adresimit të komenteve, më së largu me 30 Shtator 2019.

Për të aplikuar, ju lutemi dërgoni me anë të adresës elektronike dokumentet e listuara në vijim:

- CV e përditësuar;
- Letër interesi;
- Përmbledhje të shkurtë të metodologjisë;
- Tri (3) referenca;
- Mostra të punimeve të publikuara;
- Propozimin financiar.

Dokumentet e kërkuara luteni t'i dërgoni në adresën elektronike blerine.ukshini@d4d-ks.org, deri më **31 Korrik 2019**. Vetëm kandidatët/et e përzgjedhur do të kontaktohen për intervistë. Kandidatët/et që nuk dërgojnë ndonjë nga dokumentet e kërkuara nuk do të merren parasysh.

Ky projekt mbështetet në kuadër të Programit Angazhimi për Barazi – E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID dhe mbështetur nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim – ATRC’.